



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë , më 08.08.2023

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 31.07.2023.

Znj._____

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 31.07.2023 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1-Sa kosha për mbetjet urbane/rurale ka vendosur Bashkia Himarë në plazhin e Livadhit?

Në vijën bregdetare të plazhit të Livadhit nuk janë vendosur kosha se evadimi i mbetjeve urbane kryhet subjekt më subjekt dhe koshat janë brenda territorit të subjekteve.

2-Sa herë në ditë pastrohen mbetjet nga Livadhi?

Shërbimi i pastrimit të Livadhit kryhet 2 herë ne dite nga ora 06.00 deri ne 18.00 dhe 2 herë në mbrëmje nga ora 18.00 deri në 06.00 nga AKB.

3-A është në dijeni Bashkia Himarë për rrëshkitjen e mbajtëseve anësore të rrugës në rrugën e plazhit të Livadhit?

Po është në dijeni.

4-Nese po, për çfarë arsye nuk është vendosur një sinjalistike e përkohshme?

Në qofte se sinjalistika e vendosur nuk është ,do të rivendosim.

5-Kur parashikohet të rregullohet kjo pjesë e rrugës?

Për sa i përket rregullimit të rrugës i përket ARSH-së të cilës i kanë kaluar me VKM të gjitha rrugët që lidhen me detin nga rruga kombëtare.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!